



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	04.08.2025
REFERENC-Ë:	25/1962/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"AJH-FOODS" Sh.p.k. Fabrikë për përpunimin e mishit dhe therrjen e kafshëve, Strazhë, Novobërdë
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën me Nr.Prot.25/1962/MMPHI, për t'u pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "AJH-FOODS" Sh.p.k. për veprimtarinë: Fabrikë për përpunimin e mishit dhe therrjen e kafshëve, Strazhë, Nvovobërdë.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur,

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/1962/MMPHI
Datë: 04.08.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafët 2 dhe 3 të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

Vendim

Ndërpritet procedura administrative e shqyrtimit të kërkesës me Nr.Prot. 25/1962/MMPHI për kompaninë "AJH-FOODS" Sh.p.k. për veprimtarinë: Fabrikë për përpunimin e mishit dhe therrjen e kafshëve, në ngastrat kadastrale, nr.30, 31, 33, zona kadastrale Strazhë, Novobërdë.

A r s y e t i m

Operatori "AJH-FOODS" Sh.p.k. ka aplikuar për t'u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot.25/1962/MMPHI për veprimtarinë: Fabrikë për përpunimin e mishit dhe therrjen e kafshëve, në ngastrat kadastrale, nr.30, 31, 33, zona kadastrale Strazhë, Novobërdë, MMPHI konstaton që operatori **nuk i ka plotësuar** kushtet administrative për t'u pajisur me Leje Mjedisore.

Kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);

- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt.30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, NUI 810009383, datë: 20.03.2017, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Pëlqim Mjedisor, Nr.: 06/2983/1-ZSP-1175, datë: 15.12.2006, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Vendim për Transfer të Pëlqim Mjedisor, Nr.: 21/3206/ZSP/ /21, datë: 09.12.2021, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Aktvendim Nr.01101/2210, datë: 14.06.2006, të lëshuar nga Komuna e Gjilanit.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumentacionit si në vijim:

- Lejen Ujore për Shfrytëzim;
- Lejen Ujore për Shkarkim

Operatori nuk ka sjell dëshmi për plotësimin e dokumentacionit të lartëcekur.

Andaj, duke u bazuar në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **ndërpret procedurën administrative** për shqyrtimin e kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "AJH-FOODS" Sh.p.k.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.
Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.



U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi t'iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës-Novobërdë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.